



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri:13

Tiranë – E premte, 6 shkurt 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 7/2015 datë 29.1.2015	Për rrëzimin e dekretit nr. 8851, datë 19.12.2014, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”..... 521
Vendim i Kuvendit nr. 8/2015 datë 29.1.2015	Për rrëzimin e dekretit nr. 8894, datë 9.1.2015, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 177/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”..... 521
Vendim i Kuvendit nr. 9/2015 datë 29.1.2015	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare..... 521
Vendim i Kuvendit nr. 10/2015 datë 29.1.2015	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare..... 521
Vendim i Kuvendit nr. 11/2015 datë 29.1.2015	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare..... 522
Vendim i Kuvendit nr. 12/2015 datë 29.1.2015	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare..... 522
Vendim i Kuvendit nr. 13/2015 datë 29.1.2015	Për zgjedhjen e zotit Denar Biba anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve..... 522
Vendim i Kuvendit nr. 14/2015 datë 29.1.2015	Për zgjedhjen e zonjës Edlira Jorgaçi anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 522
Vendim i Kuvendit nr. 15/2015 datë 29.1.2015	Për zgjedhjen e zotit Gëzim Veleshnja anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 523

Vendim i Kuvendit nr. 16/2015 datë 29.1.2015	Për disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 5/2015 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”.....	523
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 7, datë 28.1.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për veprimtarinë valutore”.....	524



**VENDIM
Nr. 7/2015**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR.
8851, DATË 19.12.2014, TË
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS,
“PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË
LIGJIT NR. 154/2014, “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT””**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 8851, datë 19.12.2014, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit””.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 29.1.2015

**VENDIM
Nr. 8/2015**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR.
8894, DATË 9.1.2015, TË PRESIDENTIT TË
REPUBLIKËS, “PËR KTHIMIN PËR
RISHQYRTIM TË LIGJIT NR. 177/2014,
“PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 8588, DATË 15.3.2000, “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
GJYKATËS SË LARTË TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 8894, datë 9.1.2015, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 177/2014, “Për disa shtesa

dhe ndryshime në ligjin nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 29.1.2015

**VENDIM
Nr. 9/2015**

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit, 114 pika 3, të ligjit nr.,9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Pirro Xhixho zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 29.1.2015

**VENDIM
Nr. 10/2015**

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 114, pika 3, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Anila Denaj zgjidhet anëtare e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miruar në datën 29.1.2015

VENDIM
Nr. 11/2015

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 114, pika 3, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Ketrin Topçiu zgjidhet anëtare e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miruar në datën 29.1.2015

VENDIM
Nr. 12/2015

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 114, pika 3, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e

Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Klarina Allushi (Abazaj) zgjidhet anëtare e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miruar në datën 29.1.2015

VENDIM
Nr. 13/2015

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT DENAR
BIBA ANËTAR I KOMISIONIT
QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 14 dhe 19 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Denar Biba zgjidhet anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në vend të zotit Denar Biba dhe gëzon mandatin ligjor të tij deri në mbarim të afatit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miruar në datën 29.1.2015

VENDIM
Nr. 14/2015

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS EDLIRA
JORGAZI ANËTARE E KOMISIONIT
QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 14 dhe 19 të ligjit nr. 10 019, datë



29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Zonja Edlira Jorgaçi zgjidhet anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në vend të zonjës Albana Shtylla dhe gëzon mandatin ligjor të saj deri në mbarim të afatit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miruar në datën 29.1.2015

**VENDIM
Nr. 15/2015**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT GËZIM
VELESHNJA ANËTAR I KOMISIONIT
QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 14 dhe 19 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim”,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Zoti Gëzim Veleshnja zgjidhet anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në vend të zotit Jani Jani dhe gëzon mandatin ligjor të tij deri në mbarim të afatit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miruar në datën 29.1.2015

**VENDIM
Nr. 16/2015**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 5/2015 “PËR CAKTIMIN
E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË
PËRHERSHME TË KUVENDIT”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 21, pika 2, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Republikane dhe Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 5/2015 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, në pikën I bëhen këto shtesa:

**Komisioni për Çështjet Ligjore,
Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

1. Fatmir Mediu anëtar PR
2. Tahir Muhedini anëtar PDIU
3. Nard Ndoka anëtar i pavarur

Komisioni për Politikën e Jashtme

1. Shpëtim Idrizi anëtar PDIU

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

1. Aqif Rakipi anëtar PDIU
2. Ylli Shehu anëtar PR

**Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese,
Tregtinë dhe Mjedisin**

1. Dashamir Tahiri anëtar PDIU
2. Agron Duka anëtar PR

**Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe
Shëndetësinë**

1. Omer Mamo anëtar PDIU

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miruar në datën 29.1.2015



VENDIM
Nr. 7, datë 28.1.2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË RREGULLOREN “PËR
VEPRIMTARINË VALUTORE”

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “c” të nenit 43 dhe shkronjave “d” dhe “dh” të pikës 3 të nenit 60 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

Në rregulloren “Për veprimtarinë valutore”, miratuar me vendimin nr.70, datë 30.09.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Përmbajtja e nenit 4, ndryshon si më poshtë vijon:

“Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar ose përdorur në:

a) nenin 4 të ligjit nr. 9662, datë 23.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

b) ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;

c) ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”,

d) ligjin nr. 7764, datë 2.11.1993 “Për investimet e huaja”, i ndryshuar;

e) Ligjin nr. 52, datë 22.5.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, i ndryshuar.

2. Përmbajtja e nenit 9, ndryshon si më poshtë vijon:

- Shfuqizohet pika “iv” shkronja “a”, paragrafi 3,

- Shfuqizohet pika “i” shkronja “b”, paragrafi 4,

- Paragrafi 4, shkronja “h” ndryshon si vijon, cit:

“h. për transferimin e kapitalit brenda shumës së kapitalit dhe të të ardhurave që rezultojnë nga shitjet, nga likuidimi i pjesshëm ose i plotë i një investimi, kërkohet si dokumentacion shtesë edhe akti i shitjes ose akti i likuidimit nga organi kompetent.”.

3. Përmbajtja e nenit 14, paragrafi 1, ndryshon si më poshtë vijon:

“1. Dokumentacioni i kërkuar në këtë rregullore dhe në shtojcën nr. 1, të saj paraqitet tek subjekti i licencuar nga Banka e Shqipërisë në origjinal, ose në fotokopje të noterizuara nga origjinali. Verifikimi i dokumentacionit kryhet nga subjekti i licencuar i cili bën fotokopjen e dokumentit të paraqitur dhe vendos një vulë të posaçme (datare) mbi secilën nga fletët e fotokopjuara, e cila i jep vlefshmërinë e dubur kopjes së dokumentit të mbajtur nga subjekti.”.

4. Përmbajtja e shtojcës nr.1, (pjesa I), ndryshon si më poshtë vijon:

“I) Transfertat për veprimet tregtare me mallrat.

1. Për transfertat tregtare me mallra, subjektet e licencuara kërkojnë nga klientët e tyre, paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:

a) kërkesa për kryerjen e veprimit e nënshkruar nga vetë kërkuesi ku pasqyrohet natyra e veprimit dhe qëllimi për të cilin kryhet ky veprim. Në këtë kërkesë, subjekti deklaron se dokumentacioni i paraqitur nuk është përdorur më parë për të justifikuar kryerjen e transfertave të tjera për të njëjtin mall dhe vlerë;

b) fatura pro-forma dhe/ose kontrata ku përcaktohet dhe forma e pagesës.

5. Shfuqizohet shkronja “b” e paragrafit 3.

6. Përmbajtja e shtojcës nr.1, (pjesa II), shkronja “a” ndryshon si më poshtë vijon:

“a) kërkesën sipas paragrafit 1, shkronja “a” (pjesa I) të kësaj shtojce;”

7. Përmbajtja e shtojcës nr.1, (pjesa III), shkronja “a” ndryshon si më poshtë vijon:

“a) kërkesën sipas paragrafit 1, shkronja “a” (pjesa I) të kësaj shtojce;”

8. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

9. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Elisabeta Gjoni

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 56 lekë